



### **Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, në intervistën ekskluzive për median ndërkombëtare Deutsche Welle: Jo gjithmonë politika hesht, kur drejtësia flet.**

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, në një intervistë ekskluzive të dhënë për median ndërkombëtare Deutsche Welle (DW), thotë se pavarësia e gjykatësve për vendimet lidhet ngushtë me dhënien e llogarisë për vendimet e marra dhe se jo gjithmonë politika hesht, kur drejtësia flet.

“Gjashtë vjet pas ndryshimeve kushtetuese dhe miratimit të reformës, Këshilli i Lartë Gjyqësor, organi i ri qeverisës i gjyqësorit, e mbylli vitin 2022 pozitivisht duke pasur parasysh ku ishte gjyqësori kur nisi reforma në drejtësi dhe ku është sot. Reforma ishte shumë e thellë, preku në rrënjë sistemin gjyqësor dhe i shkaktoi atij humbje gjyqtarësh. Pothuajse 70 përqind e gjyqtarëve të Shqipërisë i janë nënshtruar, deri tani, procesit të rivlerësimit kalimtar, të njohur si vetting. Vetëm më pak se gjysma e tyre janë konfirmuar në detyrë. Nga një trupë prej gjithësej 408 gjyqtarësh, sot janë në detyrë 225 syresh, pra vettingu ka shkarkuar më shumë se 50 përqind të tyre”, – thotë në një intervistë ekskluzive për DW znj. Naureda Llagami, kryetare e këtij Këshilli.

Në vitin 2018, kur Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) filloi aktivitetin e tij, si një nga institucionet e reja në kuadër të reformës në drejtësi, ai kishte vetëm një gjyqtar, në trupën e Gjykatës së Lartë prej 17 gjyqtarësh kishte mbetur gjithashtu vetëm një gjyqtar dhe dy të tretat e Kryetarëve të Gjykatave, në nivel kombëtar, ishin shkarkuar nga vettingu, i cili po vazhdon dhe do të përfundojë në dhjetor 2024.

Znj. Naureda Llagami thotë në intervistë se “KLGJ rivendosi në funksionim Gjykatën e Lartë si një gjykatë apolitike, sikurse parashikon reforma në drejtësi. Trupa e saj ka tani 15 gjyqtarë dhe vitin 2024 do të jetë e plotësuar krejtësisht me 19 anëtarë. Këtë vit, për herë të parë në Gjykatën e Lartë arriti të reduktohet stoku prej mijëra dosjesh të pashqyrtura prej vitesh. Plotësimi i trupës së Gjykatës së Lartë, mbështetja nga KLGJ me burime njerëzore mundësoi edhe kuorumin e duhur për funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

Dixhitalizimi dhe rritja e eficiencës së shërbimeve gjyqësore

Në bilancin pozitiv të KLGJ-së bën pjesë edhe krijimi katër vjet më parë i Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me rëndësi të veçantë në kuadër të reformës në drejtësi, të cilat janë tanimë funksionale dhe pothuajse të plotësuara me numrin e gjyqtarëve që parashikon ligji. Brenda katër viteve të fundit sistemit gjyqësor i janë shtuar 80 gjyqtarë të rinj, që kanë kaluar me sukses vettingun. “KLGJ i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe

krijimit të një administrate të re gjyqësore, profesioniste, të qëndrueshme me integritet të lartë. Forcimi i kapaciteteve ka bërë të mundur evadimin më të shpejtë të stokut të dosjeve dhe po ndikon në krijimin tek publiku të perceptimit të një drejtësie më të shpejtë për qytetarët”, – thotë kryetarja e KLGJ-së.

Drejtimet kryesore në të cilat do të vazhdojë reformimi i gjyqësorit në vitin 2023, janë dixhitalizimi dhe rritja e eficiencës së shërbimeve gjyqësore. Znj. Llagami sqaron se “për këtë qëllim gjatë vitit 2023 do të zbatojmë hartën e re gjyqësore dhe do të identifikojmë partnerët që do të na mbështesin për të ngritur një sistem të integruar dhe modern të menaxhimit të çështjeve gjyqësore”.

Një drejtësi e vonuar, është një drejtësi e mohuar

Gjykatat ofrojnë sot raste jo të pakta që vërtetojnë thënien e njohur një drejtësi e vonuar, është një drejtësi e mohuar dhe drejtësia e vonuar sjell pasoja negative tek qytetarët dhe ul besimin e tyre tek shteti i së drejtës. “Që gjyqësori t’u japë drejtësi qytetarëve në kohë dhe të respektojë afatet kohore të përcaktuara në ligj”, sipas kryetares Znj. Llagami, “KLGJ do të rrisë numrin e punonjësve që ndihmojnë gjyqtarët për t’u krijuar atyre mundësi që të shqyrtojnë sa më shumë dosje gjyqësore duke i analizuar dhe kategorizuar ato paraprakisht. Ky është edhe modeli i Gjykatës së Lartë që mendojmë ta aplikojmë në Gjykatën e Apelit në Tiranë dhe atë Administrative. Një masë tjetër është rritja e kuotave të magjistratëve të rinj dhe stafëve administrative, që në katër vitet e fundit janë rritur me 300 vetë”.

Sipas kryetares së KLGJ-së “megjithatë në Gjykatat e Shkallës së parë ka shtyrje në kohë të seancave gjyqësore. Kjo lë konflikte të pazgjidhura, palët konfliktohen më shumë dhe nga çështjet e pashqyrtuara mund të arrihet në konflikte ekstreme mes palëve në proces gjyqësor. Si pasojë e vettingut dhe shkarkimit të gjyqtarëve prej tij, çështjet gjyqësore në një gjykatë kalojnë dorë më dorë tek gjykatësit, që përveç çështjeve të tyre marrin edhe ato të gjykatësve që janë shkarkuar ose janë në proces vettingu. Në këto kushte qytetari nuk merr shërbimin që kërkon dhe drejtësia nuk shkon atje ku duhet: tek qytetari”. Sidoqoftë, sipas Znj. Llagami, ligji parashikon që rastet urgjente, sensitive si ato për të miturit apo dhënia e urdhërave të mbrojtjes të kenë afate ligjore dhe asnjë nga gjykatat nuk mund t’i shkelë këto afate.

Masa disiplinore për gjyqtarët e korruptuar me zarfe me para

“Nga KLGJ puna e gjyqarit vlerësohet me anë të vlerësimit profesional”, sqaron kryetarja Znj. Llagami, “nga ana tjetër kur ka raste të shkeljes së ligjit ato trajtohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) që është krijuar dy vjet më parë dhe ka proceduar shumë raste gjyqtarësh për të cilat KLGJ ka marrë masa, duke filluar nga më të lehtat deri në ato ekstreme. Në bashkëpunim të ngushtë me ILD, në dy vitet e fundit janë iniciuar 16 kërkesa për procedime ligjore”.

“Pavarësia që i jep reforma në drejtësi vendimarrjes së gjyqarit duhet të ecë krah për krah me llogaridhënien. Sot gjyqësori në Shqipëri ka pavarësi absolute dhe roli i politikës është “zero”, – thotë Znj. Naureda Llagami.

A duhet mbrojtur sistemi gjyqësor dhe nga çfarë?

Sipas kryetares së KLGJ-së, sistemi gjyqësor duhet mbrojtur patjetër nga të gjitha retorikat që e baltosin sistemin gjyqësor. “Vërtet tani, ky sistem nuk është në fazën e tij më të mirë por i duhet dhënë kohë të maturohet. Gjithësesi, tanimë i ka të ngritura të gjitha mekanizmat dhe është i konsoliduar, ka institucionet e vettingut që po bëjnë punën e tyre të pavarur. Nëse ka raste gjykatësish të korruptuar, qytetari ka institucione ku të drejtohet”.

Një sfidë tjetër sipas Znj. Llagami është fakti që në Shqipëri ka retorikë politike dhe kjo tregon kulturë të mangët. “Por ky nuk është fenomen vetëm shqiptar. Politika duhet të vetëpërmbahet, kur në lojë janë çështje gjyqësore. Politika i ka krijuar mekanizmat për situata që ka dyshime. Ka raste kur politika hesht, ka raste kur politika e përdor sistemin gjyqësor në retorika. Ndërkohë që etika profesionale e ndalon gjyqësorin që të flasë”.

Zbatimi i Hartës së Re Gjyqësore fillon në shkurt 2023

Sipas kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, sfidat për KLGJ-në gjatë vitit 2023 do të jenë zbatimi i plotë i Hartës së Re Gjyqësore dhe reduktimi i stokut të dosjeve të pashqyrtuara.

Harta e Re Gjyqësore pothuajse e përgjysmon numrin e Gjykatave të Shkallës së Parë. Dhoma e Avokatisë e ka çuar miratimin e kësaj Harte nga qeveria Rama në Gjykatën Kushtetuese. A do të fillojë zbatimi i kësaj Harte në vitin 2023, apo do të pritet vendimi i Gjykatës Kushtetuese?

Sipas kryetares së KLGJ-së, znj. Naureda Llagami “Harta e Re Gjyqësore është një detyrim ligjor që synon të garantojë ofrimin e shërbimeve, specializimin e gjyqtarëve dhe racionalizimin e shpenzimeve financiare. Deri më sot gjykatësit, në çdo gjykatë, merren me të gjitha çështjet: civile, penale, administrative dhe tregtare. Kjo pengon specializimin e tyre dhe për pasojë rritjen e efikasitetit, produktivitetit. Zbatimi i Hartës së Re Gjyqësore, të miratuar nga qeveria Rama në korrik 2022 do të fillojë në shkurt 2023, kur në Shqipëri do të ketë vetëm një Gjykatë Apeli në nivel kombëtar. Në maj, 28 Gjykatat e Shkallës së Parë do të riorganizohen në 13 të tilla. Në korrik, 6 Gjykatat Administrative do të riorganizohen në 2 të tilla. Riorganizimi i Gjykatave do të rrisë numrin e gjykatësve në secilën prej tyre dhe do të bëjë të mundur specializimin e gjykatësve”.



## 1 SHKURT 2023

Pranë ambienteve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami zhvilloi takimin me temë “Zbatimi i Hartës së Re Gjyqësore”, i cili shënon fillimin e funksionalitetit të kësaj gjykate në zbatim të VKM-së nr. 495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”.

Në këtë takim ishin të pranishëm edhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Znj. Brikena Ukperaj dhe z. Ridvan Hado, Zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm znj. Valdete Hoxha, Drejtori i Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit, z. John C.Kastning, si dhe gjyqtarë në funksion pranë kësaj gjykate.

Në fjalën e saj, znj.Naureda Llagami deklaroi se nga sot nis funksionalitetin e plotë Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm e cila do të lejojë mundësinë e krijimit të dy seksioneve në këtë gjykatë, seksioni civil dhe seksioni penal duke bërë që të evadohet në kohë backlogu dhe qytetarët të marrin një shërbim më cilësor.

“Pa diskutim që qytetari nuk do të ketë më dështime të seancave siç ndodhte më parë për shkak të mungesave të trupës dhe mosplotësimit të trupës gjyqësore. Sipas llogaritjeve, çdo gjyqtar i kësaj gjykate do të ketë rreth 1080 çështje. Pra, çdo gjyqtar këtu ka më pak çështje se sa ka një gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë që ka shkuar në 1500 çështje. Që do të thotë që puna që ne do bëjmë këtu dhe mbështetja që do të kemi këtu padyshim që do ketë një impakt të madh në uljen e dosjeve dhe dhënien e shërbimeve për qytetarët. KLGJ ka marrë masa për staf administrativ cilësor. Kemi shkuar në nivelin që një gjyqtar të ketë 5.5 staf administrativ që asiston”, tha znj. Llagami.

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor siguroi qytetarët se me nisjen e punës së Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Apelit, shërbimi gjyqësor në vend do të përmirësohet ndjeshëm.



**8 SHKURT 2023**

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, priti në një takim pune Sekretaren e Përgjithshme të Rrjetit Evropian për Trajnimin Gjyqësor (EJTN), znj. Ingrid Derveaux e cila shoqërohej nga z. Giovanni Pasqua dhe znj. Vanja Tekic, përfaqësues të projektit të Ballkanit Perëndimor II.

Takimi u zhvillua në tone të ngrohta dhe miqësore dhe u fokusua në çështje të bashkëpunimit midis institucionit të KLGJ-së dhe Rrjetit Evropian me qëllim ngritjen e kapaciteteve në sistemin gjyqësor shqiptar. Pjesëmarrësit u dakordësuan për forcimin e bashkëpunimit dhe përmes një pjesëmarrje më aktive të Këshillit të Lartë Gjyqësor në aktivitetet e këtij Rrjeti, kjo edhe në bashkëpunim të ngushtë me Shkollën e Magjistraturës e cila aktualisht mban statusin e vëzhguesit në Rrjetin Evropian për Trajnimin Gjyqësor



Në përmbushje të detyrimeve ligjore si organ përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun, Këshilli ka caktuar në pozicionin e gjyqtarëve për mediat si më poshtë:

- Znj. Edlira Petri – në pozicionin e gjyqtares për median pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- Znj. Migena Laska – në pozicionin e gjyqtares për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- Z. Elton Frashëri – në pozicionin e gjyqtarit për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;
- Z. Ervin Sulaj – në pozicionin e gjyqtarit për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë;
- Znj. Ardiola Çela – në pozicionin e gjyqtares për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;
- Z. Gjergji Baçi – në pozicionin e gjyqtarit për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë;
- Z. Alban Veçani – në pozicionin e gjyqtarit për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë;
- Znj. Emirjana Dimo – në pozicionin e gjyqtares për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
- Z. Alfred Konomi – në pozicionin e gjyqtarit për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
- Znj. Besjana Garxenaj – në pozicionin e gjyqtares për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;
- Znj. Eva Hysko – në pozicionin e gjyqtares për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;
- Znj. Suada Kurti – në pozicionin e gjyqtares për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës;
- Z. Ardit Kuka – në pozicionin e gjyqtarit për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;
- Z. Besmir Stroka – në pozicionin e gjyqtarit për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- Znj. Blerona Hasa – në pozicionin e gjyqtares për median pranë Gjykatës Administrative të Apelit;
- Znj. Saida Dollani – në pozicionin e gjyqtares për median pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

**DEKLARATË – 8 MARS 2023**

Këshilli i Lartë Gjyqësor konstaton se ditët e fundit janë bërë deklarata nga persona publikë që shprehin pakënaqësi ndaj një vendimi të dhënë nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Si organ i ngarkuar nga Kushtetuta për të garantuar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, Këshilli i Lartë Gjyqësor konstaton me keqardhje se ky nuk është një rast i izoluar i mosrespektimit të dinjitetit të gjyqtarit, një kusht i domosdoshëm për garantimin e shtetit të së drejtës.

Gjuha e urrejtjes kundër gjyqtarëve është shqetësuese dhe e papranueshme. Thirrjet publike për vetëgjyqësi, ndaj një akti të pushtetit gjyqësor, pavarësisht mos dakordësisë me të, janë haptazi kundër rendit kushtetues, mbi bazën e të cilit funksionon shteti i së drejtës.

Aludimet për “kapje” të gjyqtarëve, referojnë elementë të korrupsionit që, në mungesë të fakteve, minojnë rëndë besimin te drejtësia dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor.

Liria e shprehjes e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nuk mbron në asnjë rast gjuhën e urrejtjes apo thirrjet për dhunë.

Për nga natyra e vet, veprimtaria gjyqësore shkakton pakënaqësi ndaj njëres apo tjetres palë, por në një shtet të së drejtës, mjeti ligjor për të kundërshtuar një vendim gjyqësor është ankimi në një gjykatë më të lartë, sipas legjislacionit në fuqi, jo përbaltja e gjykatës, apo e gjyqtarit.

Po ashtu, kushdo që vjen në dijeni të një veprimtarie apo sjellje të gjyqtarit që mund të përbëjë shkelje disiplinore sipas ligjit, ka mundësinë që rastin t’ia referojë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vlerësuar dhe vendosur nëse është vendi për fillimin e procedimit disiplinor të gjyqtarit.

20 MARS 2023

Anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, e caktuar për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun, znj. Marçela Shehu zhvilloi një takim me gjyqtarët e caktuar për mediat.

Qëllimi i takimit ishte konsultimi mbi hartimin e “Projektudhëzuesit standard të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median”. Projektudhëzuesi reflekton praktikën e deritanishme të marrëdhënies gjykatë – media/publik, si dhe praktikën më të mira ndërkombëtare të sjella nga projekti i zbatuar nga East – West Management Institute (EWMI) dhe INFOCIP.

Kjo iniciativë e Këshillit të Lartë Gjyqësor synon standardizimin e marrëdhënies të gjykatave me publikun dhe median, si dhe rritjen e transparencës, besimit të publikut dhe të kuptueshmërisë nga publiku dhe media të veprimtarisë gjyqësore.



21 MARS 2023

Kryetarja dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, pritën në një takim pune një delegacion nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i përbërë nga Kryetarja dhe 5 anëtarë të tij.

Anëtarët e dy këshillave diskutuan mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të institucioneve respektive, duke u fokusuar në mënyrë të vecantë tek procedurat disiplinore dhe marrëdhëniet me publikun. Palët dakordësuan mbi nevojën për shkëmbimim e vizitave apo organizimin e takimeve të përbashkëta edhe në të ardhmen me qëllim forcimin e mëtejshëm të marrëdhënies dhe bashkëpunimit në fushën e sundimit të ligjit.



Znj. Marçela Shehu, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, e caktuar për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun, në vijim të punës për hartimin e “Projektudhëzuesit standard të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median”, në bashkëpunim me Qendrën për Çështjet e Informimit Publik (INFOÇIP) zhvilloi një tryezë diskutimi me përfaqësues të medias.

Në këtë takim ishin të pranishëm anëtarë të grupit të punës, ekspertët e projektit EWMI si edhe disa gjyqtarë të caktuar për mediat. Përfaqësuesit e mediave u njohën me “Projektudhëzuesin standard të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median”, i cili synon standardizimin e marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median, si dhe rritjen e transparencës, besimit të publikut dhe të kuptueshmërisë nga publiku dhe media të veprimtarisë gjyqësore.

Në qendër të diskutimeve në këtë takim konsultues ishte dhënia e mendimeve mbi projektudhëzuesin, me qëllim gjetjen e mekanizmave efikase që vendosin ura të reja bashkëpunimi midis sistemit gjyqësor dhe medias.

Ky takim konsultues u mbështet nga programi “Open court through press judges”, përmes MATRA, qeveria Holandeze.





Këshilli i Lartë Gjyqësor, me mbështetjen e projektit “Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri” (SEJ IV), i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli Evropës dhe i zbatuar nga Këshilli i Evropës, zhvilloi trajnimin me temë “Komunikimi gjyqësor me median dhe publikun”.

Në këtë trajnim ishin të pranishëm znj. Marçela Shehu anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor e caktuar për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun, znj. Laurela Muca menaxhere e SEJ IV, z. Pierre Cornu dhe z. Jasa Vrabec ekspertë ndërkombëtarë të CEPEJ, z. Erion Fejzulla ekspert vendor i CEPEJ si dhe gjyqtarët e caktuar për mediat.

Gjatë takimit u prezantua Udhëzuesi i Komunikimit Gjyqësor të CEPEJ, përvoja sllovene lidhur me komunikimin më të mirë me përdoruesit e gjykatave si një mjet për të rritur efikasitetin e gjykatave dhe besimin në gjyqësor si dhe përvoja e komunikimit gjyqësor në Shqipëri.

Në përfundim të takimit, të pranishmit diskutuan rreth bashkëpunimit të mëtejshëm në lidhje me zbatimin e Planit të Komunikimit për Gjykatat.




- Në kuadër të procesit të vlerësimit etiko profesional të gjyqtarëve si dhe atij të ngritjes në detyrë, Këshilli gjatë 3 muajve të parë 2023 vendosi miratimin e **13 raporteve të vlerësimit etik dhe profesional**, për 12 gjyqtarë.
- Pas përcaktimit me short të relatorëve dhe nëpunësve përgjegjës për vlerësimin, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit si dhe fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, **viti kalendarik 2022, për 3 gjyqtarë**.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi përgjegjës për të siguruar mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor, për shkak të situatës së krijuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës nga pakësimi i numrit të trupës gjyqësore, vendosi marrjen e disa masave me qëllim përmirësimin e punës dhe efikasitetit në këto gjykata më konkretisht vendosi:
  - Hapjen e procedurës së lëvizjes paralele për **10 (dhjetë) pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe 4 (katër) pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës**;
  - Hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për **2 (dy) pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe 6 (gjashtë) pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë**.

Në vijim të këtyre masave, Këshilli ka filluar procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele për pozicionet e sipërcituara si dhe miratoi vendimet për **transferimin e 3 (tre) gjyqtareve**, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale.

- Këshilli ka vendosur ngritjen në detyrë të **gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit të znj. Rezarta Aliu**.
- Gjithashtu, Këshilli ka miratuar vendimin për **renditjen e kandidatëve** në procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 571, datë 07.12.2021 dhe kualifikimin e **një kandidateje** duke vijuar me procedurat e emërimit në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, për një kandidate.
- Këshilli miratoi vendimin për kualifikimin e **një kandidati** dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Në fokus të veprimtarisë së tij gjatë këtyre muajve Këshilli ka pasur edhe procesin e plotësimit të vendeve vakante në gjykata edhe përmes transferimit të përkohshëm me pëlqim të **9 gjyqtarëve**.
- Me qëllim ruajtjen e integritetit gjyqësor, gjatë kësaj periudhe Këshilli ka zhvilluar disa seanca dëgjimore lidhur me shqyrtimin e **kërkesave me nr. 1/2023 dhe 2/2023, të ardhura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë**, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj një magjistrati.
- Këshilli vendosi **40 kuota për magjistratë/profili gjyqtar dhe 15 ndihmës ligjorë**, që do të pranohen në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, pas vlerësimit të situatës aktuale të sistemit gjyqësor, të ndikimit nga implementimi i reformës në drejtësi dhe të kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës.
- Në kuadër të përgjegjësisë që ka lidhur me rekrutimin e gjyqtarëve të rinj, Këshilli, në vijim të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore përfshirë dhe pasurinë e figurën, të kandidatëve për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2022-2023, profili gjyqtar, vendosi kualifikimin e **3 kandidatëve**. Gjithashtu, pas caktimit të relatorëve me short, filloi procedura e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit si **gjyqtar të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2022-2023**.
- Këshilli vendosi që gjyqtari i emëruar në datën 06.03.2023, **z. Albert Keraj të caktohet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë**.

## Veprimtaria e KLGJ-së (Janar-Mars 2023):



- 19 mbledhje plenare
- 156 akte të miratura në ndihmë të të gjithë sistemit gjyqësor, më konkretisht:
  - 31 akte kolektive, Janar 2023
  - 7 akte kolektive, Shkurt 2023
  - 14 akte kolektive, Mars 2023
  - 27 akte individuale, Janar 2023
  - 15 akte individuale, Shkurt 2023
  - 30 akte individuale, Mars 2023

Pjesa tjetër përfshihen 17 akte normative nënligjore, 13 rregulla të brendshme, 1 akt i miratimit të procesverbaleve të mbledhjes plenare dhe 1 udhëzim.

## TRANSPARENCA



Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor **trajtoi 111 kërkesa për caktimin e 130 gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e çështjeve** gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

KLJGJ, në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, gjatë kësaj periudhe, ka trajtuar **11 kërkesa për informacion**, të ardhura përmes postës elektronike, të cilat morën përgjigje brenda një afati të arsyeshëm.

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun me Jashtë dhe Botimet ka trajtuar **88 shkresa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë, organizata dhe institucione publike dhe jopublike.



**KLJ FACEBOOK**

**Ndjekës në total**

**2622**

**-na ndiqni-**

---

Adresa: Godina "Poli i Drëjtësisë", Rruga "Ana Komnena", Tiranë

[www.klgj.al](http://www.klgj.al)

e-mail: kontakt@klgj.al